



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 24 gusht 2015
Nr. ref.: RK 826/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI98/14

Parashtrues

Rasim Rashica

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
PPC. nr. 39/2011, të 5 gushtit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Rasim Rashica nga fshati Bresje, komuna e Fushë-Kosovës, i përfaqësuar nga avokatja znj. Vahide Braha nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi [PPC. nr. 39/2011] i Gjykatës Supreme, i 5 gushtit 2011, me të cilin Gjykata Supreme refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës si të pabazuar dhe vërtetoi revizionin e Gjykatës Supreme të Kosovës.
3. Ky Aktvendim i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 13 mars 2014.

Objekt i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar me të cilin, siç pretendohet, është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe janë bërë shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 qershor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 4 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin GJR. KI98/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI98/14 caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
8. Më 23 janar 2015, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Me këtë njoftim, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Komunale në Prishtinë që të dorëzojnë kopjen e fletëkthesës me datën e pranimit të Aktvendimit PPC. nr. 39/2011 të Gjykatës Supreme, të 5 gushtit 2011. Gjykata, gjithashtu, i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 2 mars 2015, Gjykata Komunale dorëzoi informatat e kërkuara dhe në përgjigjen e Gjykatës Komunale qëndron se parashtruesi i kërkesës e pranoi Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës më 13 mars 2014.

10. Më 3 korrik 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues, i rekomandoi Gjykatës në përbërjen e plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 23 tetor 2003, Fondi Pensional i Korporatës Energjetike të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KEK) mori vendimin në lidhje me kërkesën për pensionimin e parakohshëm të parashtruesit të kërkesës. Në bazë të këtij vendimi, parashtruesit të kërkesës i aprovohet kërkesa për pension të parakohshëm të Fondit Pensional të KEK-ut.
12. I pakënaqur me vendimin e lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Komitetin për Shqyrtimin e Mospajtimeve të Fondit Pensional të KEK-ut. Ky Komitet e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e Fondit Pensional të KEK-ut.
13. Më 8 janar 2004, i pakënaqur me vendimin e Komitetit për Shqyrtimin e Mospajtimeve të Fondit Pensional të KEK-ut, parashtruesi ka paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
14. Më 8 qershor 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë [Aktvendimi C1. nr. 4/2004] refuzoi ankesën e parashtruesit si të paafatshme.
15. Më 28 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktvendimi Ac. nr. 38/2006] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe prishi Aktvendimin e Gjykatës Komunale, dhe të njëjtin e ktheu në Gjykatën Komunale në rigjykim.
16. Më 23 nëntor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë pas procedurës së përsëritur [Aktgjykimi C1 nr. 102/2007] miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës, duke anuluar si joligjor vendimin e Fondit Pensional të KEK-ut, me të cilin parashtruesit të kërkesës i është aprovuar kërkesa për pension të parakohshëm dhe detyroi KEK-un që paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës.
17. Kundër këtij Aktgjykimi, KEK-u paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
18. Më 14 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë [Aktgjykimi Ac. nr. 392/2008] refuzoi si të pabazuar ankesën e KEK-ut dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale.
19. Kundër këtij Aktgjykimi, KEK-u parashtrroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme. Më 3 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës [Aktgjykimi Rev. I. nr. 40/2009] aprovoi revizionin e KEK-ut, duke ndryshuar Aktgjykimin [C1 nr. 102/2007] të Gjykatës Komunale dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 392/2008] të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ashtu që kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës refuzohet si e pabazuar.
20. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, parashtruesi paraqiti kërkesë për përsëritjen e procedurës. Më 5 gusht 2011, Gjykata Supreme [Aktvendimi PPC.

nr. 39/2011] refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit për përsëritjen e procedurës.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe janë bërë shkelje thelbësore të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës.
22. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata:

“Kësaj gjykate i kërkojmë që të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 40/2009, të 03.03.2010 dhe rivendos të drejtën e humbur sipas objektit të kërkesëpadsisë (për të drejtën në kompensimin e pagave)”.

Dispozitat relevante ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë

Neni 11
Shkëputja e kontratës së punës

Neni 11.1 Kontrata e punës shkëputet:

[...]
(b) Me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit;
[...].

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

(b) aktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

27. Gjykata vëren se në këtë rast parashtruesi i kërkesës ankohet për faktin se Gjykata Supreme, duke vendosur sipas revizionit, ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë dhe e refuzoi kërkesën e tij si të pabazuar. Këtë vendim Gjykata Supreme e vërtetoi duke refuzuar propozimin për përsëritjen e procedurës.
28. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në vendimet e veta ka ofruar arsye të shumta për gjetjet e veta. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme i ka arsyetuar vendimet e veta dhe ka argumentuar çdo pretendim të parashtruesit të kërkesës në lidhje me refuzimin e propozimit të tij.
29. Në bazë të kësaj, Gjykata konsideron se shpjegimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe ligjërish i argumentuar, dhe se procedurat nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, vendimi i GJEDNJ-së të 30 qershorit 2009).
30. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin: KI10/12, parashtruesi i kërkesës *Rasim Kozmaqi*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 nëntorit 2013).

31. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës (Shih Rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
32. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova, që tregojnë se si dhe pse të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur me vendimin e kontestuar.
33. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 24 gusht 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 paragrafi 4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi